Ne teorine e pergjithshme te ngjyrave ndarja e pare behet midis tonalitetave te ngrohta dhe atyre te ftohta.

Ne tonalitetet e ngrohta kategorizohet ngjyra e verdhe, e kuqe, portokallia dhe te gjithe tonalitetet e ndermjetme. Keto jane ngjyra aktive, pozitive dhe lidhen me aksionin, me tingujt e larte dhe me levizjen e vazhduar. Nga nje eksperiment eshte vene re se zemra rreh me shpejt ne nje dhome me ngjyre te kuqe se nenje me ngjyre bojeqielli.

Tonalitetet e ftohta jane bojeqielli, blu, e purpurt, te cilat jane ngjyra te qeta, pasive qe stimulojne meditim dhe qtesi.

Ne hapesirat qe kane funksion loje dhe pune aktive, jane te keshillueshme ngjyrat dhe tonalitetet e ngrohta midis te verdhes se lehte, te verdhe ne portokalli ose portokalli te hapur sepse stimulojne prodhimin e adrenalines, dhe per rrjedhoje ndikojne ne krijmtarine dhe ne kapacitetet motorike.

Ne zonat e qeta preferohen ngjyrat dhe tonalitetet e ftohta, sepse ne pikepamjen fiziologjike, nje mjedis me tonalite jeshile-blu-bojeqielli, ndikojne ne uljen e rrashjeve kardiake duke sjelle ndjesi qtesie.

## **7.2 Perdorimi i ngjyrave**

Para se te mendohet per ngjyrat specifike, eshte e rendesishme te percaktohet se sa drite natyrale ka mjeshti. Te identifikohen zonat e vogla dhe te veshtira. Te percaktohet funksioni qe kane dhomat dhe klasat, me pas te percaktohet atmosfera qe deshirohet te krijohet, pra nese duhet e ftohte dhe harmonike apo e ngrohte, mikpritese apo e rehatshme.

Ngjyrat duhet te zgjidhen me kujdes per te krijuar ekuilibrin emocional. Veprimtarite qe ndodhin ne zonate ndryshme dote kerkojne skema te ndryshme ngjyrash dhe duke e mbajtur skemen kryesore te ngjyrave te bute, mund te perdoren ngjyra me te forta e me te ndezura ne zona si dyer, dritare, cepat dhe komizat. Si zgjidhje per te mbajtur ekuilibrin, nje nga rruget me te thjeshta e me te suksesshme eshte perdorimi i dy, tre apo me shume ngjyrave qe qendrojne prane e prane ne prizmin e ngjyrave, si: pjeshka, kajsia dhe portokallia, apo e gjelbra, e gjelber ne blu, akuamarina dhe e kaltra.

Perdorimi i ketyre skemave quhet perzierje apo harmoni, sepse te gjitha ngjyrat jane te kombinuara, te balancuara duke mos perplasur dy ngjyra.

Nese kerkohet nje atmosfera e qete dhe e fresket atehere duhet te zgjidhen ngjyra te gjelbra, si blu ne te gjelber apo blu te gjelbra. Nese atmosfera duhet e ngrohte atehere kjo arrihet me ane te ngjyres se kuqe, roze, portokalli dhe te verdhe.

## **8 IMPIANTISTIKA**

### **8.1 Standardet per projektet elektrike**

Projekti do ti referohet kushteve teknike te projektit të standardeve te Republikës se Shqipërisë (K.T.P - STASH) dhe per elementet te veçante qe nuk janë parashikuar ne keto norma, do ti referohet euronormave (EN) dhe eurostandart (EN,HD) si dhe rekomandimeve te CEI, CENELEC, DIN, VDIIVDE, ose normave lokale dhe standardeve te Komunitetit Evropian. Realizimi i instalimeve te impiantave elektrike neshkolla duhet te projektohet dhe realizohet ne praktike ne menyre te atille qe te siguroje ne cdo moment, punen normale te personelit te te gjitha llojeve te specialitetave, punen notmale tete gjitha llojeve te aparaturave duke filluar nga me te thjeshtat deri tek ato me te komplikuarat, duke siguruar afate maksimale te skemave te fumizimit, matjes, sinjalizimit dhe atyre te kontrollit. Ne mbeshtetje te gjithe ketyre kerkesave mendojme dhe propozojme qe standartet e projektit qe dote perpilojme dote mundesoje me se miri plotesimin e normave CEI te instalimeve.

#### **STANDARDET REFERUESE**

Sistemet elektrike do te jene te dizajnuara ne perputhje me rregullat dhe standartet e instalimeve nderkombetare dhe lokale.

Keshtu per INSTALIMET ELEKTRIKE dote respektohen standartet:

CEI 0-2 Udhëzues per percaktimin e dokumentacionit

CEI 11-35 Udhëzues per ekzekutimin e kabinave elektrike

CEI 11-1 Impante elektrike per tensionit alternative me te madha se 1 kV.

CEI 11-17 Impante te prodhimit, Transportit dhe shpemdarjes se energjise elektrike, Linjet elektrike.

CEI 11-20 Impante te prodhimit te energjise alternative, grupet e elektrogeneratorave telidhur ne rrjete te kategorise I dhe II.

CEI 11-25 Rrymat e lidhjes se shkurter, ne sistemet refazore alternative. Llogari jet e tyre.

CEI 11-26 Rrymat e lidhjes se shkurter, llogaritja e efekteve. Definicione dhe metoda e llogaritjeve.

CEI 17-13/1 Siguria e pajisjeve te manovrimit ne tension te ulet ( Kuadrot te tensionit te ulet)

CEI 31-30, 31/33, 31/35Konstruksionet elektrike te pajisjeve te instaluara ne zona me mundesi

eksplozioni nga prezenca e gazit. Klasifikimi i zonave te rrezikshme.

CEI 64-811 Perdorimi i impianteve elektrike ne tension nominal jo me te medha se 1000 V alternative dhe 15000V te vazhduar.

CEI 81-1011-4 Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike ( rrufe) CEI 103-111 a 103.1116 Impiantet telefonike te brendsheme

CEI te CT 210 (pajtueshmerine elektromagnetike) dhe CT 211 (ekspozimit i njeriut ndaj fushave elektromagnetike)

UNI EN 12464-I Sistemet e ndricimit te brendshem, te posteve te punes.

UNI Standard 9795 - sistemet fikse te zbulimit dhe sinjalizimit automatik, dhe alarmit te zjanit.

UNI EN 1838 Pajisjet e ndricimit, Ndricimi i emergjencës.

CEI EN 50173-1 Teknologjia e infonnacionit- Sistemet e kabllimit te per gjithshem, -Planifikime dhe kriteret e instalimeve brenda mjediseve te brendeshme

IEC 60076-11 Perdorimi I transformatoreve trefazore te thatë . IEC 103-1 /N PABX central.

6061711-2 simbolet CEI EN-grafikat e perdorura per diagrame etj

CEI 3-8 Shkurtimë dhe simbole per skicat ne plane.

CEI perdoruesit elektrike 64-811-2-3-etc

CEI / UNITe produkteve qe aplikohen per projektimin, ndertimin, testimin ne fabrike dhe instalimin e materialeve, komponenteve dhe pajisjet elektrike.

Projekti elektrike dote permbane keto sisteme:

1. Rt:ieti i fumizimit me tension te mesem TM.
2. Kabina elektrike e transformimit TMITU.
  - 2.1. Struktura e mjediseve
  - 2.2. Tipologjia e pajisjeve
  - 2.3. Skemat dhe llogari jet e ngarkesave sipas kerkesave.
3. Sistemi i fumizimit me energji emergjent-Gjeneratoret
  - 3.1 Struktura e mjediseve
  - 3.2 Tipologjia e pajisjeve
4. Sistemi i fumizimit me energji i sigurise UPS.
5. Linjat kryesore te fumizimit me energji te paneleve elektrike kryesor nga Kabina elektrike.
  - 5.1 Karakteristikat funksionale te njitette shpemdarjes kryesore
  - 5.2 RJ:jeti dytesor i shperndarjes
6. Kuadrot elektrike
  - 6.1 Kuadrot elektrike te katit, zones ....
  - 6.2 RJ:jeti dytesor i shperndarjes
  - 6.3 Kuadrot e mjediseve te vecanta.
7. Rrjeti i per gjithshem i fuqise.
  - 7.1 Fumizimi i konsumatoreve te per gjithshem nga rjeti normal
  - 7.2 Fumizim i konsumatoreve preferenciale nga gjeneratori
  - 7.3 Fumizim i komsumatoreve te rendesishem nga UPS
8. Rrjeti i ndricimit
  - 8.1 Rt:ieti i ndricimit normal te per gjithshem
  - 8.2 Rrjeti i ndricimit te nates

CEI 31-30, 31/33, 31!35 Konstruksionet elektrike te pajisjeve te instaluara ne zona me mundesi

- 8.3 RJ:jeti i ndricimit te jashtem etj.
9. Rrjeti i ndricimit te sigurise
  - 9.1 RJ:jeti i ndricimit emergjent
  - 9.2 RJ:jeti i ndricimit te evakuimit etj.
10. Rrjeti I tokezimit, shkarkimeve atmosferike dhe skemave ekuipotenciale

Projekti e instalimeve speciale dote permbane keto sisteme:

1. Impiantet e sistemeve te sigurise
  - 1.1 Impianti idedektimit dhe sinjalizimit te zjarrit dhe gazit
  - 1.2 Impanti I lajmerimit zanor
  - 1.3 Impanti kunder hyrjeve te padeshimara
  - 1.4 Impanti I kontrollit te dyerve
  - 1.5 Impanti I monitorimit CCTV.
2. Impiantet e sistemeve te komunikimit
  - 2.1 Impanti i kabllove te struktumar, fiber optike
  - 2.2 Pajisjet aktive te jetitte transmetimit tete dhenave
  - 2.3 Impanti i sinjalit televiziv, TV-SAT.
  - 2.4 Impanti videocitofonik

Sistemet e mesiperme dote jene te shoqemara mete gjithe llogaritjet, dhe specifikimet teknike te perzgjedhura.

- Sistemi i furnizimit me energji elektrike.

Ky sistem dote projektohet ne menyre te tille qe te siguroje fumizim te panderprere me energji elektrike tete gjitha mjediseve. Per kete do te parashikohen 3 burime te fumizimit me energji elektrike.

- a) Nga rrjeti elektrik energjistik i sistemit- Tension normal

Ne varesi nga organizimi i mjediseve dote behet dhe ndat:ia e li jave te fumizimit me energji elektrike. Psh sistemet e sigurise dote kene fumizim te panderprere nga UPS po keshtu zonat me ndjeshmeri te larte per femijet gjithashtu me li jat e UPS do te fumizohen dhe sistemet infomlatike, ato te majtjes se informacioneve te panderprera nese ka etj.

- b) Me tension kritik (nga gjeneratori pas 15-20 sek) dote fumizohen ato konsumatore te cilet per periudhen 15-20 sek nuk humbin parametrat e punes dhe nuk ndikojne ne zhvillimin normal te aktivitetit te shkolles.

Me kete tension dote fumizohen konsumatoret e ndricmit te per gjithshem, ndricimit emergjent, sistemet e sigurise etj.

- c) Me tension normal do te fumizohen te gjitha mjediset e shkolles duke e quajtur s1 fumizim haze te tij por qe per arsyen e sigurie dhe vazhdueshmerie do te dublohet me

ne skemat e projektit.

Per fumizimin e objektit me energji elektrike ne rastet kur fuqia e kerkuar kalon vleren mbi 150 ke dhe nuk ka mundesi per lidhje te energjise ne tension te ulet ne ate zone dote parashikohet ndertimi i nje kabine elektrike, per te cilin do te parashikohen keto dhoma tekniqe :

dhoma e tensionit te mesem

Ne kete dhoma dote vendosen bokset e tensionit te mesem sipas kesaj radhitjeje:

- a. Boksi i hyrjes se tensionit te mesem 20kv
- b. Boksi i daljes se tensionit te mesem 20kv
- c. Boksi i matjes se tensionit te mesem 20kv
- d. Boksi i takim stakimit mbrojtes TR1

Ne dhomen e dyte te parashikohen vendosjet e transformatoreve te tensionit te mesem TM 20/0.4 kv te cilet duhet te jene te tipit me rezine.

Transfmmatoret ndahen nga ambjenti me rrjete hekuri me kanaline 40x40x4 (mm) me dyer te siguruar dhe me elemente mbrojtes ne rast te hapjes se dyerve.

Ne dhomen e trete parashikohen te vendosen gjeneratoret te cilet pasi te behen kalkulimet dote percaktohet dhe fuqia e tyre.

Ne dhomen e katert dote vendoset paneli i kalimit automatik rrjet gjenerator si dhe paneli i rregullimit te cos <math>\cos \phi</math> i cili do te kalkulohet ne haze te fuqise se instaluar dhe do te paraqiten llogaritjet etj

Kuadrot e tensionit te ulet eshte mire qe per efekt tensioni te paluhatshem dhe kursimi te vendosen sa me afer mjediseve qe do te fumizojoje. Panelet e tensionit te mesem dhe gjeneratoret dote parashikohen te vendosen jashteobjektit. Kuadrot e tensionit te ulet duke u vendosur brenda godines se shkolles jane me te kontrollushem, te menaxhueshem dhe me ekonomik. Rekomandojme qe per projektin e instalimeve elektrike shtrirja e linjave te tensionit te ulet te behet duke respektuar sistemin TNS per tensionin tre fazor dhe duke respektuar sistemin TS per sistemin monofaze. Realizimi i projektit te paneleve te TU te behet konform normave CEI i programuar duke zbatuar fuqite dimensionet temperaturen, gjatesite e linjave dhe llojin e konsumatoreve. Gjate hartimit te projektit duhet te kihet parasysh qe linjat te jene te drejtperdrejta pa xhuntime te etiketuara sipas destinacionit dhe te dallueshme nga njera tjetera. Dmth Rrjeti, Gjeneratori, UPS si dhe kutite e derivacionit te etiketohen dhe te lexohen lethesisht. Kuadrot elektrik duhet pasur parasysh gjate projektit te kene ne menyre te padiskutueshme elementet mites mbrojtes kontrollues, mbrojtje nga shkarkimet atmosferike, etj. Kuadrot e tensionit duhet te sigurojne qendrueshmeri REI -120.

#### • Sistemi i ndricimit

Gjate projektit duhet patur parasysh qe ky sistem dote perfshi sa me qarte :

1. Skemat e ndricimit normal

**tensionet nga gjeneratori dhe UPS ne menyre automatike te cilat duhet te parashikohen**

2. Skemat e ndricimit emergjent
3. Skemat e ndricimit te evakuimit (Sinjalizimit)

Fluksi i ndricimit duhet te respektohet sipas mjediseve ku do te instalohet duke respektuar Lux per m<sup>2</sup> ne mjediset e qendrimit, ngrenies, mesimit, korridoreve, kuzhines, tualete etj.

Menyra e komandimit te ndricimit te jete e tillle qe te perdoret me efektivitet duke kursyer sa me shume te jete e mundur energjine elektrike. Ndricmi i perdonur te jete kryesisht me ndricues me eficense te larte energjie dhe konsum minimal, per te cilin rekomandohet ndricimi LED, me llampa ekonomike, fluoreshente etj.

- **Sistemi i fuqise neper mjedise**

Ne te gjitha mjediset te parashikohen priza monofaze qe punojne me tension normal dhe gjeneratori ne pershtatje me mobilimin si dhe dalje ndricimi ne banjo dhe aspiratori ne rast nevoje.

Ne korridore ne distanca 15 -20m te parashikohen priza monofaze me tension normal per pajisjet e pastrimit.

- **Skema ekuipotenciale**

Tek mjedise te vecanta si mjedise teknike mekanike, elektrike, kuzhine, e.j., gjate realizimit te projektit duhet patur parasysh te jene te pajisura me nje zbare ekuipotenciale te vendosur pas cdo dere ne te cilen dote jene te lidhura te gjitha pjeset metalike ne dysheme, mure apo tavane me skemen ekuipotencilale.

VO!

Realizimi i skemes ekuipotencile gjate projektimit te jete i ndare ne menyre absolute nga skema e tokezimit dhe e rrufepritesit.

Brenda kutise ekuipotenciale te parashikohet nje zbarre bakri me vrima per te realizuar te gjitha lidhjet e pikave ekuipotencile. Skema ekuipotencile filion ne 9do mjesis dhe perfundon ne elektrodat e vendosura ne toke jashte objektit.

- **Skema e tokezimit**

Gjate projektimit te skemes se tokezimit duhet te kihet parasysh qe te studiohen mire elementet si sigma e tokes, lloji i tokes, lageshtia e saj me qellim qe gjate kalkulimit rezistenza perfundimtare te jete me e vogel ose e barabarte me 4 Q. Sasia e elektrodave varet nga realizimi i RT. Gjate ma jes me diferencial me tTyma te komanduara nga 2mA-30mA releja diferenciale te veproje brenda ketij diapazoni.

- **Sistemi i rrufepritesit**

Skema dote realizohet nga projektuesi duke patur parasysh qe R<sub>r</sub> te jete me e vogel ose baraz me 10.Q. konturi mbi siperfaqen e tokes dhe ne tarrace te realizohet me shirit zinku 30x3 dhe me shtiza zinku L=1.5m ndersa konturi qarkues dhe lidhes i elektrodave ne token me percjelles bakri te zhveshur S= 50mm<sup>2</sup>. Per cdo zbri je dote vendoset shkuputesi per ma je. Numri i zbriveve ti permbahet relacionit n=P/15 +2 dhe rezistenza e rrufepritesit do te kalkulohet me vlere me te vogel se 10 om.

- Skema e furnizimit dhe kontrollit te pajisjeve mekanike dhe hidronike

Gjate realizimit te projektit te mbahen parasysh realizimi i skemave te kontrollit dhe fumizimit te elementeve te sistemit ngrohje ftohje dhe fumizim me uje. Per kete ne funksion te skemave te perqatitur nga projektuesit mekanik dhe hidro, projekti elektrik te parashikoje sa me poshte:

1. kabllimin dhe panelinin e fumizimit te chillerave
2. panelin dhe kabllimin e njesive te trajtimit te ajrit (UTA)
3. panelin dhe kabllimin e pompave (ngrohje ftohje, binjake)
4. panelin dhe kabllimin e kaldajave
5. panelin dhe kabllimin e pompes se zjarrit
6. panelin dhe kabllimin e pompave te fumizimit me uje
7. panelin dhe kabllimin e pompave zhytese

- Sistemet e sigurise

Kamerat, alarmet dhe akses kontrolli do te vendosen ne menyre te atille qe te sigurojne ne menyre te panderprere informacion ndermjet mjediseve si dhe vezhgim te gjithe situate ne te gjithe mjediset e shkolles si brenda dhe jashte.

Per realizimin e projektit te instalimeve elektrike duhet te behet nje bashkepunim dhe bashkerendim i punes ne te gjithe grupet e projektimit me qellim qe ti sherbejne sa me mire te gjithe specialiteteve dhe te realizojme nje sherbim sa me cilesor te punes se personelit dheparaturave.

- Sistemi i detektimit te zjarrit

Gjate realizimit te projektit per sistemin e detektimit te zjarrit duhet te kihen parasysh zgjedhja e detektoreve sipas funksionit qe dote kryejne dhe vendit ku dote montohen.

Gjate kryet:ies se projektit te kihen parasysh distancat e vendosjes se detektoreve, sirenave, pikave te thirt:ies ne menyre te atille qe te gjitha zonat tembulohen duke mos lejuar zonate pambuluara. Ne projekt te parashikohen detektoret multifunksional, optike , C0<sub>2</sub>, N0<sub>2</sub>, dhe detektore temperature. Pikat e thirt:ies te vendosen neper korridore ne kuotat 1 m e 40 em nga kuota 00. Sirenat e brendshme dhe te jashtme te vendosen ne pozicionet mete degjueshme dhe me akustike me te mire. Centrali qe do te perdoret duhet te zgjidhet i tille qe te japi te gjitha informacionet e sistemit, vendodhjen e te gjithe elementeve te skemes dhe te jete i pajisur me GSM. Centrali duhet te kete akses tensioni 24 dhe 48 V per komandimin e damperave elektromagneteve etj.

Lupa e keti centrali te mos kaloje 80-125 elemente duke perfshire detektore sirena e j. Centrali duhet te lidhet me sistemin e public adress te zones pa shkatuar panik ne zonat e jera, Softi i sistemit te zjarrit te zgjidhet i tille qe te jete i aksesueshem ne me shume se dy pika dhe te jape ne monitor nje situate te qarte te te gjithe sistemit.

- Sistemi Tv satelitor dhe tokesor

Ky sistem gjate projektimit te kete parasysh qe te pajisjen te gjitha dhomave te argetimit dhe qendrimit te femijeve,me sistem sinjali satelitor dhe tokesor.

- Instalimi i njoftimit zanor

Sistemi i njoftimit zanor dote perdoret per te dhene informacion personelit ne raste emergjente dhe ne raste te vecanta. Tee gjithe komponentet si altoparlantet, centrali, komponentet shpemdares dhe lidhes dote parashikohen dhe pershtaten per cdo amhjent. Ato mund te lidhen me pajisjen qendrore CD player per te vendosur muzike ne orare te pershtatshme.

Zonat/dhomat e meposhtme dote pajisen per njoftimin zanor.

- Korridoret

- Mjediset e perhashketa

Gjate fazes se projektimit, daljet e planifikuara duhet te koordinohen me ato te klientit.

- Sistemi CCTV

Ne perputhje me kerkesat dhe standartet e instalimit projekti do te parashikoje nje sistem CCTV per mjediset e perhashketa teshkollave. Ai dote mhujoje fushat e nevojshme, te kerkuara nga perfituesit qe jane te ndare ne kategori. Ne haze te ketyre kerkesave te ves;anta te s;do fushe, do te jete zgjedhja e pajisjeve qe permhush keto kerkesa. Per zonat jashte do te jene hYt:iet kryesore, si dhe kerkesat e tjera qe do te koordinohen me perfituesit, do te perdoret kamera te levizshme, te pershtatshme per instalimin, mhrojtjen anti-nderhyrje, me IP-66 rast dhe me zhulimin levizje e j.

Per zonen e hrendshme do te perdoret kamera me rezolucion te larte, te vendosur ne pikat kys;e te monitorimit. Te gjitha te dhenat e do te regjistrohen ne pajisje regjistrimi NVR, i cili do te parashikohet ne dhomen e serverit me kapacitet te llogaritur me kohen e kerkuar nga perfituesi. Ne dhomen e monitorimit dote shfaqet imazhet e kamerave ne monitori cili mhalon te gjithe hapesiren te ndare ne ekran ne sa kamera jane parashikuar.

## 8.2 Impiantistika Mekanike

Implantet mekanike jane mjaft te rendesishme per funksionimin e nje godine dhe zhvillimin normal te aktivitetit per te cilin destinohet te shfrytezohet nga perdoruesit.

Pamvaresisht funksionit dhe perdorimit te godinave, implantet mekanike duhet te plotesojne kriteret haze te domosdoshme perkundrejt projektimit, zhatimit te punimeve ne objekt dhe shfrytezimin nga perdoruesit te cilat jane:

- Pershtatshmeri dhe komfort ne perdorim,
- Besueshmeri ne funksionin e tyre,
- Kontroll te plote teknik,
- Te garantoje kushtet higjenike dhe siguri tekniqe,
- Te mundesoje perdorim parcial te adresuar,
- Te garantoje kursim te energjise se perdorur,
- Te respektoje kushtet mjedisore,
- Te garantoje kosto te uleta miremhajtje,
- Te ndertohet me komponente standard.

Projektet, punimet e zhatimit dhe shfrytezimit nga perdoruesit mheshteten ne kuadrin ligjor dhe V.K.M-te e Repuhlikes se Shqiperise dhe ne rastet kur ky kuader nuk parashikon terma ose

argumenta te ve9ante, ato mbeshteten ne standartet, norma dhe udhezime kryesisht italiane (UNI,UNIEN) dhe europiane (ISO, EN).

Per shkollat, pavaresisht ndarjes se tyre mbi haze te grupmoshave, struktures didaktike apo struktures se godinave etj, impiantistika mekanike petfshin impiantet mekanike si me poshte:

- Impianti i mbrojtjes kundra zjarrit,
- Impianti i fumizimit me uje sanitari te ftohte (H/S),
- Impianti i fumizimit me uje sanitari te ngrohte,
- Impianti i ujrave te zeza dhe te perdonura,
- Impianti i shkarkimit te ujrave te shiut,
- Impianti i ngrohje,ventilim, kondicionim.(H.V.A.C)

#### *8.2.1 Impianti mbrojtjes kundra rjarrit*

Ky impiant petfshin teresine e masave arkitektonike, konstruktive, mekanike dhe elektrike per "Parandalimin, mbrojtjen dhe ndertimin e Impianteve te Mbrojtjes Kunder Zjarrit".

Keto masa sipas funksionit dhe menyres se aplikimit ndahen ne masa te "Mbrojtjes Pasive" dhe ne masa te "Mbrojtjes Aktive".

- Mbrojtja Pasive, e cila trajton argumentat arkitektonik dhe konstruktiv te parandalimit dhe mbrojtjes nga zjarri.
- Mbrojtja Aktive, e cila trajton impiantet e dedektimit e shuarjes se zjarrit.
- Standartet, normat dhe ligjet normative nderkombetare dhe kombetare.
- Terma dhe percaktme grafike te kartelave te sinjalistikes dhe simboleve teknike.
- Terma dhe percaktme terminologjike te elementeve konstruktive, distancave, rrugeve te shpetimit, evakuimit te tymrave dhe mjeteve aktive te sinjalizim-dedektimit dhe shuarjes se zjarrit.
- Klasifikimi i zjarreve.
- Klasifikimit i nivelit te tTezikut te zjarrit.

Mjetet portative (bombolat), te shuarjes se zjarrit.

- Impiantet me dispositivo gjysem te levizshme (hidrantet, naspot) te shuarjes se zjarrit.
- Impiantet me dispozitiv te palevizshem automatik (sprinklerat) te shuarjes se zjarrit.
- Centralet e presurizimit dhe rezerva ujore per shuarjen e zjarrit.
- Rrjeti i shpemdarjes, komponentet kryesore impiantistike.
- Impianti i kontrollit dhe evakuimit te tymrave.
- Paraqitura grafike dhe dokumentat plotesues te domosdoshem per hartimin e projektit Mekanik te Mbrojtjes Kundra Zjarrit.
- Roli dhe detyrat e personelit ne njohjen, mirembajtjen, perdonimin e mjeteve te shuarjes se zjarrit dhe veprimit ne rast zjarri.

#### *8.2.2 Impianti ifurnizimit me uje sanitari te ftohte*

Nevojat per uje te ftohte hidro/sanitar.

- o Konsum sipas aparateve hidrosanitare ( 1/person)
- o Konsum sipas preferences se perdonimit te aparateve

- o Konsum mesatar ditor/person sipas destinacionit.
- Menyrat e fumizimit me uje primar dhe sigurimi i rezerves ujore
- o Nga rrjeti i qytetit
- o Nga puse private
- o Rezervuaret dhe depot e ujit
- Lidhja me rrjetin ujesjelles urban.
- Centrali i pompimit,
- Rrjeti i shpemdarjes, komponentet impiantistike.
- Materialet e tubacioneve dhe komponente impiantistike ne rrjetet e brendshme.

#### *8.2.3 Impianti i ujit te ngrohte sanitare*

Parametrat e ujit te ngrohte sanitare.

Nevojat e ujit te ngrohte sanitare.

- o Konsumi sipas aparatave hidrosanitare (1/person).
- o Konsumi sipas perdonimeve personale.
- o Konsumi mesatar ditor per person sipas destinacionit.

Pregatitja e ujit te ngrohte sanitare.

- o Me akumul elektrik, pompe nxehthesie.
- o Me impiant me rikuperim.
- o Me impiante me energji te rrinovueshme.

Dimensionimi i rrjetit te ujit te ngrohte sanitare.

Rrjeti i shpemdarjes, komponentet impiantistike.

Materialet e tubacioneve dhe komponenteve te impianteve te impiantit te rrjetit te ngrohte.

Masat e sigurise se impianteve te ujit te ngrohte sanitare.

#### *8.2.4 Impianti i shkarkimit te ujrate te zeza dhe te perdonura*

Klasifikimi i ujrate te shkarkimit

Dimensioimi i rrjeteteve te shkarkimit, Vlerat, Normative te shkarkimit.

- o Vlerat e njesive te shkarkimit sipas aparatave.
- o Dimensionet e degezimeve.
- o Dimensionet e kolonave te shkarkimit.
- o Dimensionet e kalimeve horizontale sipas pjerresive.

Ventlimi i rrjeteteve te shkarkimit.

- o Ventilimi primar
- o Ventilimi sekondar paralel/direkt.
- o Ventilimi sekondar paralel/indirekt.
- o Ventilimi sekondar unazor.

Perpunimi i ujrate te shkarkimeve

- o Perpunimi i ujrate te zeza.
- o Perpunimi i ujrate sapunoze.

- o Perpunimi i ujrave me yndyre.
- o Perpunimi i ujrave me vajra dhe karburante.
- o Perpunimi i ujrave kimike.

Rrjeti i shkarkimit, komponentet impiantistike.

Materialet e tubave dhe komponenteve kryesore te rrjetit te shkarkimit.

Masat e sigurise se impianteve te shkarkimit.

#### *8.2.5 Impianti i shkarkimit te ujrave te shiut dhe te ujrave te bardha*

Dimensionimi i rrjeteve te shkarkimit te 9ative dhe tarracave.

- o Dimensionimi i ullukeve.
- o Dimensionimi i kollonave zbritese.
- o Dimensionimi i kolektoreve te tubacioneve. o  
Dimensioni i drenazhimit sipetfaqsor.

Impiantet e shkarkimit te ujrave te bardha.

- o Ujrat e kondenses.
- o Ujrat aksidentale nga impianti M.K.Z.
- o Ujrat ne katet nentoke, nga infiltrimet etj.

Rrjetet e shkarkimit te ujrave te shiut dhe elementeve kryesore.

Materialet e tubave dhe elementet kryesore impiantistike.

Ruajtja dhe perdonimi i ujrave te shiut.

#### *8.2.6 Impianti i ngrohje, ventilim, kondicionim (H.V:A.C)*

Te dhenat meteorologjike dhe kushtet e jashtme te mjedisit. o

- Temperature e ajrit
- o Lageshtia e ajrit, o
- Rrezatimi diellor, o
- Ererat.
- o Parametrat klimatik.

Kushtet e projektimit

Impianti i kondicioniit

- o Ngrohja
- o Ftohja
- o Ventilimi -ajri i fresket

Centralet termike dhe pajisjet mekanike.

- o Centralet termike.
- o Pajisje mekanike

### **8.3 Impianti Mbrotjes Kundra Zjarrit**

Ky impiant përfshin teresine e masave arkitektonike, konstruktive, mekanike dhe elektrike per "Parandalimin, mbrojtjen dhe ndertimin e Impanteve te Mbrotjes Kunder Zjarrit".

Keto masa sipas funksionit dhe menyres se aplikimit ndahen ne masa te "Mbrojtjes Pasive" dhe ne masa te "Mbrojtjes Aktive".

### 8.3.1 Mbrojtja Pasive

Mbrojtja pasive parashikon ndertimin e godinave dhe te strukturave te saj, rrugeve te shpetimit, daljeve te emergjencës, ne menyre te tille që te reduktoje efektet e zjarrit sipas kritereve te meposhtme:

1. Kompartimentizimi i strukturave;
2. Realizimi i rrugeve, shkallevë dhe daljeve te sigurta te shpetimit;
3. Reduktim i ngarkesës se zjarrit dhe perhapjes se tij.

Mbrojtja pasive eshte subjekt i projekteve arkitektonike dhe konstruktive.

### 8.3.2 Mbrojtja Aktive

Mbrojtja aktive parashikon:

- impiantin e dedektimit dhe te sinjalizimit ne rast zjarri;
- impiantet e shuarjes se zjarrit, te tipit manuale apo automatike;
- impiantin e kontrollit te tymit dhe nxehtesise;

Impiantet e dedektimit do te trajtohen nga impiantet elektrike. Impiantet mekanike merren vetem me impiantet e shuarjes se zjarrit (te tipit manuale apo automatike).

Impiantet e shuarjes automatike apo manuale parashikohen:

- me uje,
- me gaz,
- me pluhur,
- me shkume,

### 8.3.3 Terma dhe percaktimet gjajke te kartelave te sinjalistikës dhe simboleve teknike.

Sinjalistika sherben per te ndihmuar personat te gjejne rruget e shpetimit, daljet e emergjencës, pajisjet e shuarjes se zjarrit apo telefonat e emergjencës. Sinjalistika e zjarrit, dimensionet (ne varesi te distances se shikimit), ngjyrat dhe permasat e tyre jane te percaktuara ne perputhje me normen EN ISO 7010.

Per te lehtesuar daljen ne rast emergjencë duhet te montohen tabelat informative te meposhtme:

Tabela informative te ndriuara, te cilat do te tregojne daljet e emergjencës dhe korridoret e daljes. Keto tabela duhet te mbahen gjithmone te ndezura gjate gjithe kohes dhe te jene te lidhura dhe me linjen elektrike te emergjencës (korridoret e daljes se sigurte duhet te evidentohen dukshem me ndriuim ne dyshemë ne do kondicion dhe me do ndriuim);

Tabela informative, ne zonat ku jane prezent femijet, dhe qe te tregojne:

- prezencen e shkallevë dhe/ose pengesa ne rruget horizontale;
- rruge jo lineare;
- prezence te elementeve konsol;

Sinjalistika gjithashtu duhet te realizohet edhe me mjete te tjera:

- nepermjet nje sistemi komunikimi zanor;
- nepermjet nje siperfaqe me konsistence te ndryshme;
- nepermjet nje kontrasti kromatike ne dysheme te cilat jane te dukshme ne te gjitha kushtet e ndri9imit.

	Ngjyra	Kuptimi ose qellimi	Udhezime dhe sqarime
Kuqe		Sinjale ndalimi	Sjellje te rrezikshme
		Rrezik- alarm	Ndalim, mekanizmat e nderprerjes se emergjences
		Materiale dhe patsje kunder zjarrit	Identifikim dhe vendndodhje
D	E Verdhe ose e Verdhe portokall	Sinjale paralajmerimi	Kujdes, verifiko
Blu	Bojeqelli	Sinjale urdheruese	Sjellje ose veprim i percaktuar - detyrim per te mbajtur nje mjet te sigurise personale
Jeshile		Sinjale te shpetimit ose te ndihmes	Dyer, dalje, rruge, materiale, pozicione, ndertesa.
		Situata te sigurise	Rikthim ne normalitet

8.3.4 *Terma dhe percaktimet terminologjike te elementeve konstruktive, distancave, rrugave te shpetimit, evakuimit te tymrave dhe mjeteve aktive te sinjalizim-dedektimit dhe shuarjes se zjarrit.*

*Ngarkesa e zjarrit:*

Potenciali termik i totalit te materialeve te djegshem qe ndodhen ne nje hapesire, duke perfshire edhe muret, veshjet e tyre, dysheme e soleten. Shprehet ne "kg dru ekuivalent".

*Materialet*

Komponenti (apo bashkim komponentesh) qe mund te marri pjese ne djegie ne varesi te natyres se tij kimike dhe te kushteve efektive te venies ne pune per perdonim.

*Reagim -sjellja ndaj zjarrit :*

Transformim kimik dhe fizik i nje materiali apo nje elementi ndertimor subjekt i aksionit te zjarrit. Reagimi ndaj zjarrit perfshin rezistencen ndaj zjarrit te strukturave dhe veprimi ndaj zjarrit i materialeve.

### *Rezistenca ndaj zjarrit*

Sjellja e nje elementi konstruktiv (komponent apo struktura) per te ruajtur stabilitetit, qendrueshmerine dhe izolimin termik, nen ndikim e zjarrit per nje kohe te caktuar, i teri apo i pjesshem.

R - stabiliteti: gjendja e nje elementi tekonstrukzionit per te ruajtur rezistenen mekanike nen ndikimin e zjarrit.

E -qendrueshmeria: gjendja e nje elementi te konstrukzionit per te mos prodhuar apo lejuar depertimin nga njera ane ne tjetren, te flakes, avujve apo gazrat e nxehete, nen ndikim e zjarrit.

I - izolimi termik: gjendja e nje elemneti te konstrukzionit per te reduktuar brenda nje kufiri te caktuar transmetimin e nxehtesise.

### *Filtr i proves se tymit:*

Hapesire e kufizuar e strukturesme rezistence ndaj zjarrit REI e paracaktuar (jo me e vogel se REI 60), e pajisur me dy ose me shume porta te pajisura me mekanizem vete-mbyllies me rezistence ndaj zjarrit REI te paracaktuar (jo me e vogel se REI 60), me oxhak ventilimi me seksion te pershtatshem (jo me e vogel se  $0.1 \text{ m}^2$  shfryrese siper mbuleses se nderteses), ose hapesire me te njejtat karakteristika te rezistences ndaj zjarrit e mbajtur ne mbipresion me te pakten  $0.3 \text{ mbar}$  edhe ne kushte emergjence apo e ajrosur drejtpersedrejti Direkt per nga jashte me hapje te lira te siperfaqes jo mete vogel se  $1 \text{ m}^2$  me perjashtim te kanaleve. Filtri i proves se tymit nuk mund te jete i pajisur me hapje per ajrim normalisht te mbyllura dhe mbipresioni nuk mund te realizohet pas mbylljes se portave.

### *Interkaped antizjarr :*

Hapesire e shkeputur me funksion aJnmm dhe/ose shkarkimin e produkteve te djegies te largesise terthore jo mete vogel se  $0.6 \text{ mZ}$ , me funksion kalimin e personave me largesi terthore jo mete vogel se  $0.9 \text{ m}$ . Persegjati eshte e kufizuar nga muret perimetrale (me apo pa hapje) qe i perkasin godines ose nga toka natyrale dhe/ose nga muret perimatral te godinave te tjera qe kane nje rezistence te caktuar ndaj zjarrit.

### *Hapesire e zbuluar*

Hapesire ne qiell te hapur apo e mbuluar me grile edhe pse e kufizuar nga te gjitha anet, me siperfaqe minimale ne kat jo me te vogel se ajo e llogaritur e shumezuar per 3 metra lartesi te murit me te ulet qe e kufi.zon.

### *Distanca e jashtme e sigurise*

Vlera minimale e percaktuar me norme e distancave te matura horizontalisht permes perimetrite ne planin e cdo elementi te rrezikshem te nje aktiviteti dhe e perimetrit te godines me te afert jashte vete aktivitetit apo te godinave te tjera (publike apo private) apo krahasuar me kufijte e godines per te cilat keto distanca duhen te jene te vezhguara.

### *Kompartimentizim zjarri:*

Pjese e nderteses e kufizuar nga elemente konstruktiv rezistent ndaj zjarrit e paracaktuar dhe organizuar per tu pergjigjur nevojave te parandalimit te perhapjes se zjan·it.

### *Distancat e brendshme te sigurise*

Vlera minimale e percaktuar me norme e distancave te matura horizontalisht midis perimetrit ne plan te cdo elementi te rrezikshem te nje aktiviteti.

### *Distancat e mbrojtura*

Vlera minimale e percaktuar me norme e distancave te matura horizontalisht midis perimetrit ne plan te cdo elementi te rrezikshem te nje aktiviteti apo rrithimi, kufiri i zones ne te cilin zhvillohet aktiviteti.

### *Densiteti i popullimit*

Numri maksimal i njerezve te gjendur per njesi ne nje siperfaqe bruto te dyshemese ( persona/m<sup>2</sup>)

### *Kapaciteti i fluksit ose i zbrazjes se personave*

Numri maksimal i personave qe ne nje sistem me rruge dalje, supozohet qe mund te zhvendosen drejt nje dalje tip "modul ". Te dhena te tilla te percaktuara nga normat marrin parasysh kohen e nevojshme per shfryrjen e zakonshme te nje kompartimenti.

### *Maksimumi i popullimit hipotetik*

Numri i personave i pranuar ne nje kompartiment. Eshte percaktuar nga produkti i densitetit te popullimit me siperfaqen bruto te dyshemese.

### *Shkalle e jashtme e sigurise*

Shkalle totalisht e jashtme ne krahasim me godinen, sigruar me parapet dhe me karakteristika te tjera te percaktuar me norme.

### *Shkalla me prove tymi*

Shkalle ne nje hapesire ne kompartimentizimin e zjarrit qe ka akses ne cdo kat me dyer rezistente ndaj zjarrit RE e paracaktuar dhe e pajisur me mekanizem vete mbyllses nga nje hapesire e zbuluar apo nje hapesire e hapur te pakten nga njera ane e pajisur me parapet.

### *Siperfaqja bruto e kompartimenteve*

Siperfaqja ne kat ( $m^2$ ), e perfshire brenda perimetrit te brendshme te mureve kufizuese te kompartimentit.

### *Largesia e daljeve te 9do kompartimenti*

Numri kompleksiv i moduleve te daljeve te nevojshem per evakuimit totale te kompartimentit.

### *Vendi sigurt*

Vend i hapur apo kompmtiment zjarri i ndare nga kompartimentet e tjera me hapesira te hapura ose me filter me prove tymi, duke patur karakteristikat e pershtatshme per te pritur e mbajtur nje numer te percaktuar personash (vendi sigurt statikisht) apo qe lejon levizjen e rregullt.

### *Lidhje me motopompen*

Pajisje e perbere nga nje valvol nderprerese dhe nje valvol moskthimi, e pajisur me nje apo me shume lidhje te unifikuara per tu lidhur me tuba fleksibel kundra zjarrit. Sherben si fumizim hidrike

### *Shuares karrelato (e levizshme)*

Pajisje qe mban nje agjent shuares qe mund te jete projektuar e drejtuar mbi nje zjarr nen veprimin e nje presioni te brendshem. Eshte konceptuar per tu levizur e perdonur mbi nje karroce per shkak te madhesise.

### *Shuares portativ ( te levizshem)*

Pajisje per shuarjen e zjarrit me simbole, kapacitet dhe kerkesa teknike te percaktuara sipas DM.

### *Hidrant antizjarr*

Lidhje e unifikuar e pajisur me valvol nderprerese me hapje manuale e lidhur me nje rrjet per fumizimin me uje. Hidranti mund te jete i pozicionuar ne mur, ne kollone siper tokes ose ne toke.

### *Impiant automatik per zbulimin dedektimin e zjarrit*

Bashke me pajisje te tjera elektrike per dedektimin e zjarrit bejne te mundur lokalizimin dhe sinjalizimin automatik te fillimit te zjarrit.

### *Impianti i alarmit*

Bashke me pajisje te tjera me veprim manual sherbejne per te sinjalizuar nje fillim zjarri.

### *Implant jiks i shuarjes*

Bashke me sistemin e fumizimit me uje, me valvolat, me rrjetin e tubacioneve dhe hedhesat e ujit per te shkarkuar agjentin shuares te pershatatshem mbi nje zone ku ka rene zjarri. Aktivizimi dhe funksionimi i tij mund te jete automatik ose manual.

### *Hundez hedhese*

Pajisje e parashikuar me nje vrime me seksion te pershatatshem me nje lidhje te unidfikuar. mund te jete e pajisur edhe me nje valvol qe lejon mbushjen e plate ,te pjesshme ose nderprerjen e ujit.

### *Naspo*

Pajisje kundra zjarrit e perbere nga nje bobine e levizhme mbi te cilen rrotullohet nje tubacion gjysem fleksibel i lidhur nga njeri skaj i i tij ne menyre te perhershme me nje rrjet te fumizimit me uje ne presion dhe qe mbaron ne ekstremitetin tjeter me nje hundez hedhese e pajisur me valvol rregulluese dhe mbyllese te hedhjes se ujit.

### *Rrjet hidrantesh*

Sistem tubacionesh fiks ne presion per fumizimin me uje ne te cilat jane te lidhur nje ose me shume hidrant zjarri.

### *Rezerve e substancave shuarese*

Sasia e shuaresve e percaktuar nga autoritetet e destinuar ne menyre te perhershme per nevojat e shuarjes see zjarrit.

### *Tubacion fleksibel*

Tub ne te cilin seksioni behet rrethor kur vihet nen presion dhe qe paloset ne kushte jo presioni.

### *Tub gjysemfleksibel*

Tub ne te cilin seksioni mbetet lethesisht rrethor edhe se nuk eshte ne preswn.

#### *8.3.5 Klasifikimi i ;jarreve.*

Ne haze te normave / standarteve bashkekohore, pajisjet shuarese te zjarrit jane klasifikuar ne gjashte klasa. Standarti european CNVVF/CPAI UNI 9485 per keta shuarsa dallon klasat e meposhtme:

##### 1. Klasa I

Perdoret per zjarre qe e kane origjinen prej materialeve te ngurte sikurse derrase, leter, plastik, tekstile,etj. Uji, shkuma dhe pluhuri jane substancat shuarese mete zakonshme per t'u perdonur

per zjarre te tilla. Pajisjet qe do perdoren per te shuar zjarrin jane bombulat portative, naspot, hidrante apo cdo pajisje tjeter shuarese me uje.

## 2. Klasa II

Perdoret per zjarre qe e kane origjinien prej materialeve te lengshem sikurse benzene, benzole, nafte, alkol, vajra etj. Per kete shuareset me te zakonshem per tu perdonur jane me shkume, pluhur dhe C0<sub>2</sub>(dioksid karboni).

## 3. Klasa III

Perdoret per zjarre qe kane origjinien prej materialeve te gazte sikurse metan , propan , butan GPL etj. Nderhyrja kryesore ne raste te tilla zjarri eshte bllokimi i fluksit te gazit duke mbyllur valvolen nderprerese ose duke mbyllur fleten. Kjo mase merret per shkak te rrezikut te shperthimit te gazit perpara se zjarri te shuhet. Shuareset qe perdoren per kete rast janEC0<sub>2</sub> (dioksid karboni, pluhura kimik dhe gaze halone.

## 4. Klasa IV

Perdoret per zjarre qe kane ongpnien prej materialeve metalike qe digjen sikurse alumin, magnesium, sodium, etc. Shuareset qe perdoren per kete rast jane pluhura kimik special nen veprimin e nje personeli te specializuar si dhe C0<sub>2</sub>(dioksid karboni).

## 5. Klasa V

Perdoret per impiante dhe pajisje elektrike qe jane nen tension. Shuareset perdoren per kete rast janEC0<sub>2</sub> (dioksid karboni, pluhura kimik dhe gaze halone.

## 6. Klasa VI

Perdoret per zjarre qe kane ongpnien ngavajra vegetali dhe shtazore (ne kuzhinat e gatimit).Shuareset qe perdoren per kete rast janete vecante .

### 8.3.6 Klasifikimit i nivelist te rrezikut te rjarrit

Vleresimi i rrezikut te zjarrit eshte procesi i vleresimit te rrezikut te zjarrit ne nje objekt qe rrjedhin nga mundesia reale e shfaqjes se zjarrit. Ne vleresimin e rrezikut te zjarrit merren parasysh:

lloji i aktivitetit qe kryhet  
substanca dhe materialet e depozituara  
karakteristikat konstruktive, dimensionet dhe shpemdarja e tyre ne godine ( struktura, siperfaqja e katit, siperfaqja totale, mbulesa etj )  
numri maksimal i hamendesuar i personave qe mund te jene prezent ne te njejten kohe ne godine me objektivin: per te percaktuar faktoret e rrezikut te zjarrit, identifikimi i

personave te ekspozuar ndaj rrezikut te zjarrit, vleresimi i rrezikut te krijuar, identifikimi i masave parandaluese dhe mbrojtse, programimi i masave te mbrojtjes kundra zjarrit mete pershatshme.

Gjithashtu mjaft e rendesisheme eshtedhe identifikimi i personave te ekspozuar ndaj rrezikut te zjarrit duke marre parasysh popullimit maksimal te parashikueshem, te kushteve psiko-fizike te personave te pranishem duke vleresuar nese ne brendesi te zones se punes mund te kete prani te rastesishme te personave te tjere, te cilet nuk jane te familjarizuar me vendin e punes dhe me rruget e shpetimit dhe te emergjences ne vecanti; apo persona ne varesi te moshes te cilet jane te paafte te perdonin mjetet e shuarjes apo te vetevakuohen.

Referuar normes UNI EN 12845 rreziku klasifikohet :

1) Rrezik i vogel -LH (Light Hazard)

-Aktivitet me ngarkesa tevogla dhe djegeshmeri te ulet ne nje hapsire jo mete madhe se 126m<sup>2</sup>.

-Rezistence ndaj zjarrit per te pakten 30 minuta.

Mbrotje e brendshme	Mbrotje e jashtme	Kohezgjatja
2hidrant: prurje 120 l/min presion ne dalje 0.2 MPa	Ne per gjithesi nuk parashikohet mbrotje e jashtme	30 min
Ose		
4 naspo: prurje 35 l/min presion ne dalje 0.2 MPa		

2) Rrezik i zakonshem -OH (Ordinary Hazard)

Ngarkesa ne te cilen trajtohen produkte apo materiale me ngarkese mesatare te djegshmerise nga zjarri. OH, eshte ndare ne 4 nengrupe:

- OH1, Grupi i Rrezikutte Zakonshem 1;
- OH2, Grupi i Rrezikut te Zakonshem 2;
- OH3, Grupi i Rrezikut te Zakonshem 3;
- OH4, Grupi i Rrezikut te Zakonshem 4.

Mbrotje e brendshme	Mbrojtje e jashtme	Kohezgjatja
3 hidrant: prurje 120 l/min presion ne dalje >0.2 MPa  Ose	4 lidhje DN 70 : prurje 300 l/min presion ne dalje 2:: 0.3 MPa	2:: 60 min
4 naspo: prurje 60 l/min presion ne dalje >0.3 MPa		

### 3) Rrezik i larte - HH (Hight Hazard)

Kjo klase eshte ndare ne dy pjese:

Rrezik i Larte- Proces -HHP (High Hazard, Process) Rrezik i Lartel depozituar -HHS (High Hazard, Storage)

Mbrotje e brendshme	Mbrojtje e jashtme	Kohezgjatja
4 hidrant: prurje 120 l/min presion ne dalje >0.2 MPa  Ose	6 lidhje DN 70 : prurje 300 l/min presion ne dalje 2: 0.4 MPa	2: 120 min
6 naspo: prurje 60 l/min presionne dalie >0.3 Mpa		

#### 8.3.7 Mjetet portative (bombolat), te shuarjes se {,jarrit.

Zjarni eshte ndare ne klasa te ndryshme. Fjalet PO apo JO nenkupton pershatjen e seciles bombol per perdonimin ne vecanti te nje klase zjarni.	Dioksidi i karbonit (CO <sub>2</sub> )	Pluhur kimik i thate	Shkume	Kimjkate te lenget.'l	Lengje avulluese
Kategori A	I limituar	PO -AB(E) JO -B (E)	PO	PO	PO
Kategoria B	I limituar	PO	PO	JO	Ilimituar

Kategoria C	JO	PO	JO	JO	Ilimituar
Kategoria E	PO	PO	JO	JO	PO
Kategoria F	JO	JO- AB(E)	Ilimituar	PO	JO
		PO- B(E)			

Zgjedhja e fikesave portative duhet te behet duke marre parasysh edhe materialet nga se mund te nise zjarri. Pesha e tyre varion nga 6 kg - 12 kg. Perjashtim bejne fikeset karrelato qe kane peshe 20-150 kg. Fikeset portative klasifikohen ne haze te :

- Llojit te agjentit shuares qe permbajne
- Aftesisese tyre per te shuar zjarrin;
- Sasia e agjentit shuares qe ato permbajne;

Fikeset portative mund te jene me :

- Pluhur;
- Shkume;
- Gaz.

Pavaresisht llojit te agjentit shuares, fikeset jane te ndertuara:

- Nga nje bombol, depozite per mbajtjen dhe ruajtjen e agjentit shuares;
- Valvola per te nderprerere apo rregulluar fluksin e agjentit shuares;
- Zorra, tubi fleksibel per te drejtuar fluksin e agjentit shuares.

#### 8.3.8 Impiantet me dispositivo gjysem te levizshme (hidrantet, naspot) te shuarjes se ;jarrit.

Hidrantet e zjarrit te tipit kasete me prurje 120 l/min dhe presion ne dalje jo me pak se 2 bar, jane te perbere prej sara9ineskes nderprerese, tubit te gomuar per kalimim e ujit me nje gjatesi prej 30m, lan9es si dhe hundeza. Te gjitha keto pajisje jane te vendsura ne boksin prej llamarine 9eliku, i cili vendoset ne brendesi te murit dhe ka nje nivel me siperfaqen e tij.

Hidrantet duhet te instalohen ne menyre te tille qe :

- Te instalohen site pavarur per 9do kompartimentizim;
- Te pozicionohen ne afersi te daljeve e rrugeve te shpetimit pa u here pengese;
- Te jene te pozicionuar ne te dy anet e portes nese ka porte REI;
- Te mbulojne 9do hapesire te aktivitetit;
- <do hidrant te mbroje nje zone me siperfaqe deri ne 1000 m<sup>2</sup>;
- <do pike e zones se mbrojtur te jete ne distance maksimale 20 m per hidrantet mural dhe 30 m per naspot;

Hidrantet e zjarrit te jashtem te tipit kollone mbi toke me prurje 350 lim dhe presion ne dalje jo me te vogel se 2.5 bar, jane te perbere nga nje kollone qe del nga nentoka ne te cilien jane pozicionur lidhjet qe mundesojne fumizimin e ujit. Hidranti eshte i perbere nga kollona me dy dalje perkatesisht DN 70 dhe DN 100 me tapa te lidhura me zinxhir, dhe 9eles manovre (opsional).

Hidrantet kollone siper toke dhe hidrantet nentoke duhet te instalohen ne menyre te tille qe :